



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 117, Datë 27.07.2017

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SH.A. PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS SË SHIT-BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKË ME SHOQËRINË STAR NRG SH.P.K. NË MËNYRË TË NJËANËSHME.

Në mbështetje të neneve 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 14 të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike të miratuar nga Bordi i ERE me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016, dhe nenit 26të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e Shoqërisë “OSHEE” sh.a., për miratimin e përfundimit të kontratës së shit-blejjes së energjisë elektrike me Shoqërinë “Star NRG” sh.p.k., në mënyrë të njëanëshme, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 13983 Prot., datë 31.05.2017, ka paraqitur pranë ERE, kërkesën për miratimin e përfundimit të kontratës së shit-blejjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k. në mënyrë të njëanëshme.
- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k. me shkresën nr. 27 Prot, datë 03.06.2017, ka paraqitur pranë ERE, kërkesën për mosmiratimin e përfundimit të kontratës së shit-blejjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k. në mënyrë të njëanëshme, të kërkuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a..
- Shoqërisë “Star NRG” sh.p.k. në mënyrë të përsëritur i është bërë me dije se nuk është subjekt i trajtimit nga ERE për shkak të mos qenit subjekt i licencuar, ndaj kërkesa e saj për trajtim nga ERE është e pambështetur në ligj.
- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k. në kuptim edhe të kontratës sa më sipër nuk ka kontratë shitblerje të HEC—eve për të cilat pretendon se ka vetëm kontratë qiraje nga Blerësi “Projeksion Energji” sh.a. Kjo kontratë për shkak të mungesës së autoritetit ligjor të administratorit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. dhe vendimit të gjykatës sipërcituar është nul.

- Shoqërive “Star NRG” dhe “Projeksion Energji” sh.a. u është thënë në mënyrë të përsëritur që HEC-et për të cilat ka licencë shoqëria “Projeksion Energji” sh.a. nuk mund t’u tjetërsohen palëve të treta nëse nuk nënshkruhet kontrata nga të dy aksionerët e shoqërisë.
- Gjykata është shprehur me vendim për ndalimin e aksionerit të “Projeksion Energji” sh.a., Z.Anastas Riska që të sillet si administrator i shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.. Reuzlton, që kontrata e qirasë mes “Projeksion Energji” sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k. të jetë nënshkruar nga aksioneri sa më sipër.
- Edhe për ERE kontrata mes Z.Anastas Riska dhe “Star NRG” sh.p.k. është nul për sa më sipër dhe kjo i është bërë me dije në korrespondencë zyrtare “OSHEE” sh.a., “Projeksion Energji” sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k.
- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k. nuk është subjekt i licencuar nga ERE e mbështetur në *“Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”*, të miratuar nga Bordi i ERE, nuk është objekt trajtimi nga kjo e fundit.
- Nëse nuk ka kontratë që të dëshmojë titull pronësie/të drejtë shfrytëzimi mbi një HEC, nuk mund të konsiderohet shoqëri tregtare që ushtron aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike, pra prodhues.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “OSHEE” sh.a. për përfundimine njëanshëm të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike të lidhur mes “OSHEE” sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k. me nr. 20560/1, datë 21.09.2016.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE
Adriatik BEGO